

SHFK "BEDRI TAIRI"- SVILLARË E POSHTME

V E T E V A L U I M I



Viti 2022/2024

Hyrje në vetvlerësimin e shkollës

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi i shkollës është një proces i monitorimit, analizimit dhe vlerësimit sistematik dhe të vazhdueshëm të punës dhe arritjet me të vetmin qëllim promovimin e veprimtarisë arsimore dhe sigurimin e cilësisë në punën e shkolles.

Procedura e vetëvlerësimit të shkollës kërkon përgjigje në tre pyetje kryesore:

Sa është e mirë shkolla jonë?

Si e dimë atë?

Çka mundë të bëjmë që të jetë më mirë?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve bazohen në të dhëna objektive dhe relevante, si dhe në njohurit reale në funksionimin e shkollës

Qëllimet e vetëvlerësimit

Strukturimi i sistemit të brendshëm shkollor për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e punës së shkollës;

Përfshirja e të gjithë subjekteve në procesin e zhvillimit të shkollës: drejtori, bashkëpunëtorët profesional, mësuesit, nxënësit, prindërit, komuniteti lokal dhe i biznesit;

Sigurimi i pavarësisë, përgjegjësisë dhe inovacionit më të madh në shkollë;

Marrja e masave për punë më efikase dhe më cilësore, duke arritur kështu rezultate më të mira;

Zbulimi i dobësive dhe problemeve me të cilat përballet shkolla dhe ndërmarrja e veprimeve për tejkalimin e tyre;

Përcaktimi dhe monitorimi i treguesve dhe kriterëve të matshëm për vlerësimin e cilësisë së procesit arsimor në shkollë.

Menaxhimi efektiv dhe efikas i shkollës nga drejtori;

Rritja e ndikimit të jashtëm në shkollë dhe të gjitha subjektet e përfshira në punën e saj, në përgjithësi politikën arsimore përmes një artikulimi të qartë të nevojës për zhvillimin e shkollës.

TË DHËNA PËR SHKOLLËN

Emri i shkollës	SHFK "Bedri Tairi"			
Adresa	Svillarë e Poshtme			
Periudha	2022/2024			
Telefoni			E-mail	
	707880152		oubedritairi@hotmail.com	
Drejtori	Neim Rexhepi			
Kryetar i këshillit të Shkollës	Nexhmedin Fejzulla			
Lloji i shkollës	Shkollë fillore komunale			
Nr. i nxënësve 2021/22	455			
Nr. i të punsuarve	Arsimtarë	B. profesional	Personeli teknikë dhe nikoqiri	Gjithesëjt
	38	2	6	46
Shkolla periferike	Svillarë e Epërme			

Mënyra e kryerjes së vetëvlerësimit

Në baz të nenit 129, paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit për Arsimin fillor (Gazeta Zyrtare e RSM, nr. 161 -2019), shkolla zbaton në çdo dy vjet vetëvlerësim për punën dhe arritjet në shkollë.

Këshilli i shkollës, pas propozimit të drejtorit, formoi Komision Shkollor në muajin janar 2024 i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë nga radhët e mësuesve, bashkëpunëtorëve profesional dhe prindërve/kujdestarëve.

EKIPI I VETEVALUIMIT

Emri dhe mbiemri	Funksioni në shkollë
1.Bejtulla Idrizi	Pedagog
2.Hirmete Alili	Psikolog
3.Shermine Mamuti	Arsimtare e grupit klasor
4.Halil Latifi	Arsimtarë i gjuhës gjermane
5.Nexhmedin Fejzulla	Prindë

KORDINATOR I EKIPIT PËR VETEVALUIM

Emri dhe mbiemri	Bejtulla Idrizi
Funksioni në shkollë	Pedagog
Tel.	070 901 475
E-maili	bej_sasa@hotmail.com

Procesi i vetevaluimit

Metodologjia e zbatuar në procesin e vetëevaluimit zhvillohet në disa faza

Formimi i ekipeve për vetëevaluim

Aplikimi i treguesve të duhur, metodave dhe instrumenteve

Mbledhja e të dhënave

Analiza e gjendjes

Hartimi i planit zhvillimor të shkollës

Ekipet për vetevaluim

Nr.	Fushat	Lideri i ekipit	Anëtarët
1.	Organizimi dhe zbatimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies	Halil Latifi	Suzana Berisha Lumturije Jusufi Hatixhe Devaja Burbuqe Idrizi
2.	Arritjet e nxënësve	Suzana Berisha	Murat Ameti Medina Selimi Ajser Jakupi Halil Latifi
3.	Zhvillimi profesional i mësuesve, bashkëpunëtorëve profesional, edukatorëve dhe stafit drejtues	Medina Selimi	Belkisa Rexhepi Mersije Sulejmani Elife Ejupi Sejfulla Huneli

4.	Menaxhimi dhe Udhëheqja	Rexhep Mejdiu	Hatmi Ameti Sara Ramani Ismet Ameti Artan Jetishi
5.	Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun	Jahi Ejupi	Adifete Korana Rejhan Mustafa Ajser Jakupi Metije Fazliu
6.	Klima dhe kultura e shkolles	Vebi Rexhepi	Mirvedete Idrizi Hatixhe Devaja Burbuqe Idrizi Ajser Jakupi
7.	Bashkëpunimi me prindërit dhe mjedisin lokal	Ismet Ameti	Artan Jetishi Murat Ameti Jahi Ejupi Halil Latifi

FUSHA 1: ORGANIZIMI DHE ZBATIMI I MËSIMDHËNIES DHE MËSIMNXËNIES

Nr.	Treguesit e kualitetit	Temat
1.1	<i>Realizimi i planeve dhe programeve mësimorë</i>	<i>Aplikimi i programeve vjetorë dhe krijimi i vizionit për atë se çka duam të arrijmë;</i> <i>Informimi i prindërve dhe nxënësve mbi planet dhe programet mësimorë;</i> <i>Përgatitja i programeve mësimore për fëmijët me nevoja të veçanta;</i> <i>Zgjedhja e programeve mësimorë;</i> <i>Planifikimi i aktiviteteve për realizimin e orëve të lira aktiviteteve projektuese të shkollës;</i> <i>Realizimi i programeve me ndryshime sistemorë.</i>
1.2	<i>Cilësia e planeve dhe programeve mësimorë</i>	<i>Barazia gjinore dhe etnike dhe ndjeshmëria multikulturore në programet mësimorë dhe mjetet ndihmës mësimorë;</i> <i>Bashkëpunimi me mjedisin lokal në programet mësimorë dhe mjetet ndihmës;</i> <i>Integrimi i qëllimeve të përgjithshëm (ndërlëndor) në arsim dhe përcaktimi i prioriteteve për përmirësim;</i> <i>Ndikimi i arsimtarëve dhe prindërve në planet dhe programet mësimorë.</i>
1.3	<i>Aktivitetet jashtëmësimorë</i>	<i>Vëllimi dhe llojllojshmëria e aktiviteteve të planifikuar dhe të realizuar jashtëmësimorë;</i> <i>Përfshirja e nxënësve në aktivitetet jashtëmësimorë;</i> <i>Inkuadrimi i nxënësve në zgjedhjen dhe planifikimin e punës gjatë aktiviteteve jashtëmësimorë;</i> <i>Afirmimi i nxënësve dhe shkollës përmes aktiviteteve jashtëmësimorë.</i>

1.1. Realizimi i plan-programeve mësimorë

Burimet e të dhënave	Niveli i evaluimit: <i>Shumë mirë</i>
♥ Planet dhe programet mësimorë të sjellë nga Byroja për zhvillimin e arsimit	Planifikimi i punës vjetore nga arsimtarët është në përputhshmëri me dokumentet programorë të sjella nga MASH. Planet dhe programet mësimorë janë në vëllimin e duhur dhe sipas vizionit të shkollës për mësim bashkëkohor, cilësor dhe efikas në shek. 21 me arritje dhe zhvillim maksimal si dhe edukim i nxënësve dhe arsimtarëve.
♥ Planifikimet vjetorë-tematik të arsimtarëve	Arsimtarët rregullisht i ndjekin seminarët dhe trajnimet që organizohen nga Byroja për zhvillimin e arsimit për realizimin e planeve-programeve mësimorë;
♥ Aktet normativ të shkollës	Procesi mësimor në shkollë realizohet në bazë të planeve dhe programeve mësimore të sjella nga MASH, të përshtatur sipas kushteve, mundësive dhe nevojave në mjedis dhe shkollë.
♥ Evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik	Shkolla shfrytëzon disa mënyra për informimin e anëtarëve të Këshillit të prindërve dhe prindërit tjerë si dhe të gjithë të interesuarit për bashkëpunim me shkollën tonë.
♥ Programi vjetor për punën e shkollës	Nxënësit njihen me planifikimin e mësimit përmes planifikimit tematik, javor dhe orëve klasore.
♥ Procesverbalet nga Këshilli i prindërve	Përmes Këshillit të prindërve dhe Këshillit të shkollës janë planifikuar aktivitete për përmbledhje dhe shqyrtimi të mendimeve dhe propozimeve për planet dhe programet mësimorë.
♥ Procesverbalet nga mbledhjet prindore	
♥ Procesverbalet nga Këshilli arsimor dhe aktivet profesional të shkollës	
♥ Udhëzimet dhe kahjet profesionale për operacionalizimin e planeve dhe programeve mësimorë	

-
- ♥ Ftesat për pjesëmarrje në seminare
 - ♥ Përfaqësimi i lëndëve zgjedhore sipas paraleleve
 - ♥ Ditarët e klasave
 - ♥ Përgatitja për gara
 - ♥ Program për ndryshime sistemore nga BZHA në pajtueshmëri me MASH
 - ♥ Broshura
 - ♥ Web portalet

Shkolla punon me nxënës me nevoja të vecanta arsimore që janë të kycur në mësim ku arsimtaret kanë përgatitur programe të adaptuar për punë me nxënësit me nevoja të vecanta në të gjitha lëndët mësimore.

Shkolla jonë i ofron lëndët zgjedhore sipas planit mësimor. Zgjedhja e lëndëve mësimore bëhet sipas rregullave, ku respektohen të gjitha normat. Secila lëndë zgjedhore hyn në mësimin e rregullt pasi të formohen grupet mësimore.

Shkolla në programin vjetor planifikon aktivitete të lira të cilët realizohen nëpërmjet sekcioneve të ndryshëm në mësimin lëndor.

Shkolla është e hapur për ndryshime dhe realizon projekte për përmirësim të mësimin përmes ripërtrirjes apo inovacioneve në mësimin klasor dhe lëndor.

1.2. Kualiteti i plan-programeve mësimorë

Burimet e të dhënave	Niveli i evaluimit: <i>Shumë mirë</i>
♥ Aktivet profesional ♥ Aktet normative të shkollës ♥ Procesverbalet nga Këshilli arsimor dhe aktivet profesional të shkollës ♥ Biseda me arsimtarë dhe prindër ♥ Procesverbalet nga aktivet profesional ♥ Procesverbalet nga këshilli arsimor ♥ Intervistë me drejtorin ♥ Anketa me arsimtarë, prindër dhe nxënës ♥ Program për ndryshime sistemore nga BZHA në pajtueshmëri me MASH ♥ Broshura ♥ Web portalet	Plan-programi mësimor plotësisht e ndihmon zhvillimin personal dhe shoqëror të nxënësve, pa dallim të gjinisë, shtresës sociale apo etnisë cilës i përkasin. Kjo bëhet me përfshirje adekuate nëpërmjet të realizimit të përmbajtjeve nga: <i>shkathtësitë jetësore, kulturës qytetare</i>, përemes të realizimit të temave të caktuara gjatë orëve klasore dhe në bashkëpunim me shërbimin pedagogjik të shkollës. Ekzistojnë shembuj të integritit të vecorive të mjedisit lokal në pjesë të caktuara të planeve dhe programeve mësimorë si dhe mjeteve mësimorë me përmbajtje adekuate që korespondojnë me rrethinën e afërt. Shkolla është e hapur për ndryshime dhe përsosjen e mësimiit përmes përtrirjes së lëndëve mësimore të mësimiit kllasor dhe lëndor në raport me standardeve të notimit. Në bashkëpunim me BZHA, MASH si dhe organizatave të akredituara për edukacion (p.sh. universiteteve në RM), janë organizuar seminare dhe trajnime të arsimtarëve në fusha të ndryshme. Gjatë realizimit të përmbajtjeve mësimore në lëndë të ndryshme ka shembuj të qasjes integrative të qëllimeve në mes lëndëve mësimore në programet klasore. Arsimtarët me përgjegjësi i realizojnë qëllimet në mes lëndëve. Në shkollë funksionojnë aktivet profesional.

1.2. Aktivitetet jashtëmësimorë

Burimet e të dhënave

- ♥ Bisedë me drejtorin
- ♥ Bisedë me nxënës, arsimtarë dhe prindër
- ♥ Evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik
- ♥ Programi vjetor për punë
- ♥ Raporti i gjysmëvjetorit dhe vjetor për punën e shkollës
- ♥ Program për mësimin plotësues-shtues dhe aktivitetet e lirë të nxënësve
- ♥ Rezultatet nga pjesëmarrja në gara të ndryshme
- ♥ Lëvdata
- ♥ Falënderime
- ♥ Anketa
- ♥ Bisedë me shërbimin profesional

Niveli i evaluimit: *Shumë mirë*

Skolla planifikon dhe realizon aktivitete jashtëmësimore të karakterit të ndryshëm që pasqyrojnë interesat dhe nevojat e nxënësve.

Shkolla mundëson që pothuajse të gjithë nxënësit të kycen në aktivitetet jashtëmësimorë në pajtueshmëri me dëshirat, interesat dhe mundësitë e tyre duke i inkuadruar në këto aktivitete edhe nxënësit me nevoja të posacme dhe ata me status të ulët socio-ekonomik.

Nxënësit inkuadrohen në këta aktivitete sipas zgjedhjes së tyre dhe ata e kanë rolin kryesor gjatë përgatitjes të këtyre aktiviteteve ndërsa arsimtarët e janë këshillëdhënës dhe koordinues të aktivitetit.

Nxënësit janë përherë të stimuluar dhe inkurajohen nga shkolla dhe arsimtarët që të marrin pjesë në garat dhe manifestimet lokale, ndërshkollore, komunale, qytetare dhe shtetërore. Të përmbajtur nga shkolla dhe arsimtarët, nxënësit mundohen që të arrijnë rezultate sa më të lartë në garat e fushave të ndryshme të organizuara në nivelet e lartpërmendur.

Rezultate më të mirë janë arritur në garat e ndryshme në olimpiadat e organizuar nga komuna Saraj dhe garat e ndryshme që realizohen ne vend.

Për rezultatet e arritur çdoherë janë lëvdur në mënyrë adekuate dhe janë shpallur në tabelat shpallëse (gazetë muri) në shkollë.

Rezultatet

Përparësitë:

- ♥ Arsimtarët të mësimit klasor dhe atij lëndor rregullisht i përgatisin planifikimet vjetorë të punës mësimore.
- ♥ Në trajnimet dhe seminarët të organizuar në lidhje me tematikën e planifikimit të punës mësimore janë pjesëmarrës të rregullt dhe aktiv.
- ♥ Orët për aktivitetet e lirë organizohen dhe realizohen përmes seksioneve të ndryshëm në pajtueshmëri me interesat, nevojat dhe mundësitë e nxënësve.
- ♥ Shkolla realizon arsimim për të drejtat e njeriut në mësimin klasor nëpërmjet lëndës së shoqëris dhe në mësimin lëndor arsimimi qytetar.
- ♥ Shkolla organizon dhe realizon aktivitete jashtëmësimorë, projekte të domeneve të ndryshëm, aksione të karakterit ekologjik dhe solidar si dhe ekskursionet e nxënësve.
- ♥ Nxënësit përfshihen në aktivitetet jashtëmësimore në mënyrë të barabartë duke mos bërë dallime në gjini, Përfaqësimit etnik apo gjendjes socio-ekonomike të tyre.

Dobësitë:

- ♥ Disa arsimtarë kanë nevojë për trajnime shtesë lidhur me planifikimin e mësimit në kushtet e ndryshimeve të shpejta në jetën arsimore dhe shoqërore.
- ♥ Arsimtarët kanë nevojë për trajnim për punë me nxënës me nevoja të vecanta.
- ♥ Mungesa e psikologut dhe defektologut në shkollë.
- ♥ Gjatë zgjedhjes së lëndëve zgjedhore nga plani mësimor ndodhë që mos bëhet sipas të gjitha normave të nevojshme.
- ♥ Edhe pse nxënësit me nevoja të vecanta arsimore janë të inkuadruar në aktivitetet mësimorë dhe jashtëmësimorë, ata janë pjesërisht aktiv në gjatë realizimit të këtyre aktiviteteve.

Analiza e rezultateve

Në bazë të vrojtimeve dhe kontrollimeve nga indikator i parë, është konstatuar se shkolla jonë i aplikon planet dhe programet mësimorë aktual të sjellë nga BZHA dhe MASH.

Respektohen procedurat për transferim të informatave deri te nxënësit, prindërit dhe subjekteve tjerë që bashkëpunojnë me shkollën.

Organet e shkollës i planifikojnë dhe i kryejnë aktivitetet pedagogjik.

Shkolla e adapton punën sipas nevojave dhe ka përpunuar kahje për realizimin e qëllimeve.

Poashtu, shkolla ofron më tepër lëndë zgjedhore dhe realizon programe të zgjëruar për nxënësit e ciklit të lartë përmes mësimi plotësues dhe shtues.

Numri i nxënësve me nevoja të vecanta arsimore është tejet i vogël dhe arsimtarër kanë qasje dhe kërkesa individuale sipas mundësive dhe nevojave të tyre.

Gjatë planifikimit të punës mësimore dhe veglave mësimore respektohen dallimet dhe ndjeshmëria gjinore, etnike apo psikosociale, integrohen nevojat dhe vecoritë të mjedisit lokal dhe qëllimet ndërlëndore.

Edhe pse shpesh reagohet lidhur me përmbajtje të caktuara në programet mësimorë, për vërejtjet është biseduar në aktivet profesional, këshillin klasor dhe arsimor si dhe në seminare, por nuk është ngritur procedurë e rregullt për plotësimin apo ndryshimin e tyre.

Shkolla jonë planifikon dhe realizon aktivitete jashtëmësimorë me qëllim të nxitjes së zhvillimit personal dhe shoqëror të nxënësve. Nxënësit inkuadrohen sipas zgjedhjes së tyre të lirë (duke u bazuar në bisedat dhe anketat me nxënësit) dhe e gëzojnë mbështetjen e plotë për afirmimin tyre nëpër gara, manifestime të ndryshëm dhe aktivitete tjerë jashtëmësimorë.
